WISCONSIN FOOD CODE FACT SHEET
FLETË FAKTESH E KODIT TË USHQIMIT TË SHTETIT WISCONSIN

~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~ Hand Washing ~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~
~~~~~~~~~~~~~~~~~ Larja e duarve ~~~~~~~~~~~~~~~~~

Larja e duarve është mënyra e vetme më e mirë dhe efektive për parandalimin e përhapjes së baktereve dhe viruseve që mund të shkaktojnë infeksione dhe sëmundje që vijnë prej ushqimeve.

Punonjësit mund të jenë një burim i rëndësishëm i mikroorganizmave të dëmshëm. Larja e përshtatshme e duarve mund të jetë veprimi më efektiv që punëtorët mund të ndërmarrin për të kontrolluar direkt dhe indirekt ndotjen e ushqimit, mjeteve të guzhinës dhe pajisjeve.

Kur duhen larë duart

- Para fillimit të punës me ushqim, mjete guzhine ose pajisje.
- Gjatë përgatitjes së ushqimit, sipas nevojës.
- Kur ndërroni punën midis ushqimeve të pagatuara dhe ushqimeve të gatshme për t'u ngrënë.
- Mbas kapjes së mjeteve të guzhinës dhe pajisjeve të ndotura.
- Mbas kollitjes, teshtitjes, përdorimit të shamisë ose mbas përdorimit të produkteve të duhanit.
- Mbas ngrënies dhe pirjes.
- Mbas prekjes së lëkurës suaj.
- Mbas prekjes së kafshëve.
- Mbas përdorimit të banjës, lani duart në lavamanin e larjes së duarve në banjë: dhe lajini përsëri mbas kthimit në punë.

Ndiqini gjithmonë këto gjashtë hapa kur të lani duart

Para larjes së duarve, hiqini të gjitha stolitë e çmuara dhe vetëm lani duart në lavamanë që janë caktuar për larjen e duarve. Mos i lani duart në lavamanët e mjeteve të guzhinës, përgatitjes së ushqimit ose të shërbimit.

1. Përvishini mëngët dhe lagini duart me ujë të ngrohtë.
2. Përdorni sapun, jo ndonjë solucion dezinfektues duarsh, sapunisni derisa të bëhet një shkumë e mirë sapuni mbi duart dhe parakrahët.
3. Fërkojini duart së bashku për të paktën 20 sekonda: sigurohuni të lani pëllëmbët, kurrizin e duarve, mes gishtërinjve dhe parakrahët.
4. Përdorni një furçë për thonjtë e gishtave të dorës për të pastruar nën thonj dhe midis gishtave.
5. Shpëlani duart dhe parakrahët me ujë të ngrohtë.
6. Thani duart me peshqirë letre me një përdorim të vetëm ose peshqir beze në rrotulluese. Mbylleni çezmën duke përdorur peshqir letre për të parandaluar rindotjen e duarve.